



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-15336/24 datë:20.06.2024



Npi – 01/224 datë: 21.06.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 21.06.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 21.06.2024 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF-së, Nga UNMIK-u, z.Xhavit Fejza dhe Srecko Bogajcevic. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.05.2024,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (pas diskutim publik),
3. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, në rregull është sa i përket pikave të rendit të ditës, për sa i përket KAB-it ne ende nuk e kemi materialin nga diskutimi publik i KAB-it. Ndoshta drejtorja ka qenë e nxanun edhe nuk e di a kemi material për këtë. Meqenëse edhe drejtori erdhi në mbledhje atëherë do ta bisedojmë më gjatë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete me 5 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.05.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.05.2024.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (pas diskutim publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Drejtorin e kemi prezent dhe ja japim fjalën për një prezantim të shkurtë. E di që Komuna ka organizuar debate publike në të gjitha vendbanimet.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje, buxheti është mbi 10 milion euro, jemi duke punuar intensivisht për ta përfunduar draftin final të KAB-it. Buxheti është paraparë momentalisht për 870.000 euro më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Buxheti i planifikuar për 2025 10.777.180 euro. Pra tani për tani nuk mundemi me u ndalë në specifika të draftit final sepse ende jemi duke punuar në te por e pash të arsyeshme me ardhë në mbledhje dhe me ju njoftuar se deri ku kemi arritur. Debate publike ka pasë gati në secilin vendbanim dhe ka ekzistuar mundësia për secilin që me i paraqitë kërkesat e veta.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Sa është buxheti i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe a parashihet pranimi i zyrtarëve në këtë zyre?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Po i kemi paraparë edhe zyrtarët në ZKKK-në edhe një përgjegjës por aktivitetet duhet me i realizuar përmes drejtorisë kompetente. Ndërsa buxhetin për ZKKK-në ende nuk e kemi definuar.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, sa vende të reja pune po planifikohen të hapen?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Nuk e dimë ende këtë.

z.Besnik Seferi; Është me rëndësi që me përmend se ju drejtor jeni i angazhuar dhe i përgaditur për këtë fushë. Më erdhi mirë që e thatë se do të bëhet një gjithpërfshirje. A keni bërë planifikim për kokë banori për investimet kapitale? Është me rëndësi aktivizimi i Qendrave Mësimore në bashkpunim me DKA-në. Duhet me i futë edhe 2 rrugë në Gjyrvocv. Te rruga “Besnik Sopa” Gjyrvocv për zgjerimin e kësaj rruge. Ne duhet ti rekomandojmë Kuvendit rritjen e buxhetit të ZKKK-së nga 8.500 euro me rritë në 10.000 euro bashkë me buxhetin e zyrtarëve.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, është mirë të rritet ky buxhet. Alokimi është bërë dhe ne e dimë se janë edhe 7 kërkesa.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Të gjithë anëtarët e Komiteteve e kanë të drejtën për me apliku edhe për subvencione sikurse të tjerët.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, kemi pas një kërkesë të Driton Demirit, për një kërkesë prej 500 euro që është bërë operacion dhe është refuzuar.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t’i Rekomandoj Kryetarit të Komunës së Shtimes, që ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së buxhetit për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim nga shuma 8.500€ në 10.000€, dhe me e futë në Korrnizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2025-2027.**

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi, Drejtorisë Komunale për Arsim, që ta shqyrtoi mundësinë për ta futur në Korrnizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2025-2027, edhe buxhetin për financimin e Qendrave Mësimore në Gjyrvocv dhe Vojnovc.**

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, që të shikon mundësinë, për ti futur në Korrnizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2025-2027, asfaltimin e pjesëve të tri rrugicave si vijon: Rruga “ Hysiqi ” – Shtime, Rruga “ Enver Gashi” – Shtime’ Rruga “ Eqrem Qabej “ – Shtime.**

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:04h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

